



**Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit(Gllogoc)**

**Zyra e Kuvendit të Komunës  
Nr. \_\_\_\_\_ dt. 2014**



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- Z. Naim Bazaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Nexhat Demakun



LËNDA:Dërgimi i akteve te miratuara nga Kuvendi i Komunës se Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt:27.06.2014

1. Projekt Korniza afatmesem buxhetore Komunale 2015-2017
2. Rregullore për Tarifa dhe ngarkesa në palestrën Sportive Drenas
3. Vendim për emertim të rrugëve dhe institucioneve tjera publike në territorin e komunës se Drenasit

Më dt:03.07.2014

Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Praniar		20	
Nj. Org	Numër	Shtojca	Vlera
500-27 267			



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E DRENASIT  
Zyra e Kuvendit**

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE  
2015-2017**

**Drenas, 27.06.2014**

## I.Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB), që po e prezantojmë është një dokument i cili miratohet në Kuvendin e Komunës për çdo vit. Kjo Kornizë është një material që siguron dhe paraqet një informatë si për të hyra dhe dalat publike në nivel komunal dhe përcakton parametrat dhe priorititetet kryesore për zhvillimin e vazdueshëm të buxhetit vjetor. KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm, për mes të cilave përcaktohen objektivat prioritare, të identifikuara në dokumente strategjike të komunës, që të integrohen sa ma mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore, përmban një detyrim për programe-nënprogramet buxhetore të komunës të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale nr. 2015-1 për Komunat e Kosovës e lëshuar nga Ministria për Financa.

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritari të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve në komunë dhe shpërndarjen e të hyrave komunal për periudhën 2015-2017.

Korniza Afatmesme Buxhetore, për periodën 2015-2017 do të hartohet, ndryshohet, plotësohet dhe do të aprovohet sipas procedurave të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë për Financa dhe do të kaloi nëpër katër faza si vijon:

- Faza e parë, KAB, si draft, përcaktimi i sektoreve dhe prioriteteve komunale,
- Faza e dytë, KAB, konsultimet në organet e komunës dhe subjektet tjera me interes,
- Faza e tretë, KAB, shqyrtohet dhe miratohet në Komitetin për Politik dhe Financa dhe
- Faza e katër, KAB, shqyrtohet dhe miratohet në Kuvendin e Komunës dhe dorzohet në Ministrinë për Financa para 30 qershorit 2014.

## II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike të zhvillimit

Komuna e Drenosit, si që dihet shtrihet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, në një sipërfaqe prej: 290 km<sup>2</sup>, e cila komunë ka 58,531 banor që jetojnë në 42 vendbane – fshatra dhe në qytetin e Drenosit. Komuna ka një pozitë të përshtatshme gjeografike se pse shtrihet në mes të Kosovës, në luginën e lumit Drenica, në një largësi prej 32 km. nga Prishtina e cila luginë lidhë rrafshin e Kosovës me rrafshin e Dukagjinit. Kjo lidhje e teritorit në mesë regjioneve dhe qyteteve Prishtinë – Drenas- Pejë, Prishtinë-Drenas-Skenderaj- Mitrovicë etj. ka rëndësi ekonomike se pse mundëson qarkullimin më të lehtë të udhëtarëve dhe mallrave etj. ka qarkullim bëhet kryesisht për mesë rrugëve dhe hekurudhës që lidhë këto qytete.

Qarkullimi i udhëtarëve dhe i mallrave edhe në të ardhmen do të rritet për mes teritorit të kësaj komune, pasi tanë është rregulluar rruga dy anësor(autostrada) që mundëson një lidhje dhe qarkullim më të shpejtë dhe më të mirë.

Ekonomia e Drenasit, është e dominuar nga bujqësia dhe prodhimet kryesore bujqësore janë gruri dhe misri. Drenasi për kah industria njihet me shkritisoren e "Feronikelit," e cila shkritisore tani është privatizuar.

Në Komunën e Drenasit, numri më i madh i të punësuarve është në "Feronikel" kurse në Institucionet shoqërore dhe publike numri i të punësuarve është mbi 1300 punëtor. Një numër i punëtorëve është i punësuar edhe në bizneset private të cilat biznese e zhvillojnë veprimtarinë në teritorin e Komunës së Drenasit, dhe jasht teritorit të komunës, ky numër i punëtorve nuk dihet së mungonë evidencë e sakët.

Me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017 të Komunës së Drenasit, synohet të arrihen këto objektiva :

- a) zhvillimin ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) formimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve, drenazheve, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal;
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollar, fillor dhe të mesëm;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për strehim familjar raste emergjente, përkujdesin e fëmijëve, përkujdesin për të moshuarit;
- l) banimin publik;
- m) shëndetësinë publike;
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- p) aktivitetet kulturore dhe të lira.

### III. ORGANIZIMI I KOMUNËS PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE

Komuna e Drenasit, për realizimin e objektivave në periodën tri vjeçare do të ketë strukturën e organizimit sipas këtyre zyrave dhe sipas drejtorateve :

- Zyra e Kryetarit,
- Zyra e Kuvendit,
- Zyra për Komunitete,
- Drejtorati për Administratë dhe Personel
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa,
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër,
- Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
- Drejtorati për Inspeksion,
- Drejtorati për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ,
- Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport,
- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale dhe
- Drejtorati për Arsim.

Planifikohet së në periudhën e ardhshme tri vjeçare të punësuar në zyre dhe drejtorate të komunës numri i përgjithshëm i stafit do të jetë 1312 punëtor, I njejtë me vitin 2014.

Punëtorët që egëzistonjë tanë janë të sistemuar ashtu si që kanë përgatitjen shkollore dhe aty ku mund të kontribuojnë më shumë në drejtim të kryerjes së shërbimeve të qytetarëve. Të gjitha drejtoratet por edhe zyret, do të janë të organizuara në mënyrën më të mirë që ti kryejnë detyrat për çka edhe janë themeluar si dhe të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të komunës.

#### **IV. KORNIZA EKONOMIKE FISKALE**

Ndonë se komuna nuk udhëheq drejtë për së drejti politikën makro ekonomike, ( kjo është kompetencë e Qeverisë Qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si e tillë do të trajtohet si vijon, shif tabelen më tutje.

Korniza Afatmesme Buxhetore e komunës është në përputhje me Kornizën Makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizëz Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2015-2017) të perpiluar nga Qeverija e Kosovës.

Bazuar në indikatorët makroekonomik të paraqitura në Kornizën Afatmesem të Qeverisë së Kosovës në të cilën është e bazuar edhe Korniza Buxhetore Komunale shifet se gjatë peridës 2015-2017 kemi një rritje pozitive të bruto produktit vendor dhe at si vion:

- 4.3% gjatë vitit 2015,
- 4.4% gjatë vitit 2016 dhe
- 4.5% gjatë vitit 2017.

Aktualishtë financimi komunal përfshin : të hyrat vetanake dhe grantet, ndërsa aspekti i huamarjës së komunës do të jetë si opcion i mundëshem i financimit që është l paraparë në ligjin përkatës dhe rregullës fiskale të përcaktuar me LMFPP të dakorduara me Misionin FMN-ës.

**Tabela nr.1. Indikatorët ekonomik komunal:**

Përshkrimi	2014(aktual)	2015	2016	2017
<b>Indikatorët</b>				
<b>Makroekonomik në</b>				
<b>Kosovë :</b>				
BPV	4.1%	4.3%	4.4%	4.5%
BPV për kokë banori:	2.5%	2.7%	2.8%	2.9%
Konsumi	3.9%	4.5%	2.7%	3.6%
Investimet	2.1%	1.8%	6.4%	5.6%
Exporti	5.8%	4.8%	6.1%	4.9%
Importi	3.2%	3.6%	2.3%	3.3%
<b>Indikatorët ekonomik</b>				
<b>Komunal :</b>				
Popullsia e Komunës	59,745	61,059	62,402	62,450
Nr.I biznes.të regjistruar	2,445	2,807	3,212	3,659
Numri i nxënësve:	14,500	13,909	13,700	13,600

Komuna e Drenasit, për të arritur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik do të fokusohet në priorititet e sektorëve në nivel komunal dhe si vijon:  
 -Krijimi i ambientit të favorshëm përritjen e investimeve në nivel komunal nga ana e bizneseve të teritorit të komunës,jashtë komunës dhe atyre të shteteve tjera;

-Vazhdimi i investimeve në projekte me prioritet sipas sektorëve që ndikojnë drejtë përsë drejti në zhvillim ekonomik dhe në përmisimin e infrastrukturës publike;

-Vazhdimi i projekteve dhe përkrahja në bujqësi me qellim të rritjes së prodhimtarisë bujqësore, stimulimi i tyre me subvencione dhe ndihma tjera si dhe me dhënjen e këshillave profesionale;

-Vazhdimi i investimeve lidhur me zhvillimin e mjedisit, hulumtimit të ujërave përsigurimin e tij për pije.

Komuna në periodën tri vjeçare do të synoi rregullimin dhe përmirsimin e infrastrukturës që rregullon lëmin e bizneseve që do të janë të favorshme për ta.

Komuna duke u bazuar në analizat buxhetore nga vitet paraprake, informatat financiare në lidhje me të hyrat komunale dhe Qarkoren Buxhetor nr. 2015-1 për Komunat e Kosovës planifikon këtë kornizë të t'hyrave komunale sipas sektorëve dhe sipas viteve;

**Tabela nr. 2.**

Të hyrat sipas Sektorëve	Aktuali:	Projeksi:		
		2014	2015	2016
Sektori I Administratës:	4,413,420	5,554,385	5,585,175	5,713,049
Sektori I Arsimit:	5,235,673	4,833,086	4,872,735	4,898,936
Sektori I Sjëndetësisë:	1,333,256	1,431,848	1,495,186	1,532,068
<b>Gjithsej të hyrat:</b>	<b>10,982,419</b>	<b>11,819,319</b>	<b>11,953,096</b>	<b>12,144,053</b>

Në tabelën nr. 2 është paraqit korniza makrofiskal e cila kornizë është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës. Kjo kornizë paraqet, kornizën e të hyrave dhe të dalave të Komunës së Drenasit.

Shuma e mjeteve, të paraqitura në tabelë do të realizohet kryesisht nga grantet e qeverisë dhe nga të hyrat vetanake të komunës. Të njëjtat mjete do të shpenzohen sipas sektorëve dhe sipas viteve.

Shikuar të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit sipas viteve, shifët se nga viti në vit kemi një rritje të t'hyrave dhe të shpenzimeve në nivel komunal, që sa do që është një rritje e ulët prapë së prapë është indikator i mirë që do të ndikoj në zhvillim ekonomik të komunës. Kjo rritje do të ndikoj pozitivisht në Sektorin e Administratës dhe të Shëndetësisë për kryerjen e shërbimeve në nivelin e kërkuar si dhe në Sektorin e Arsimit për një mësim më cilësor.

## V. Burimi i të hyrave

Burmet kryesore të t' hyrave të Komunës gjatë viteve 2015-2017 do të janë:

- a. Grantet nga niveli qëndror dhe
- b. Të hyrat nga burimet vetanake.

Komuna gjatë viteve 2015-2017 parashef të realizoi edhe të hyra nga donatorët dhe bashkëfinancueset tjera.

Grantet nga niveli qëndror do të janë:

- granti i përgjithshëm,
- granti për arsim dhe
- granti për shëndetësi-shërbime sociale.

Të hyrat vetanake të komunës, planifikohen të realizohen nga:

- tatimi në pronë,
- taksat- ngarkesat e ndryshme ,
- të hyrat nga pasuria dhe
- gjobat e ndryshme.

Të hyrat nga donatorët dhe bashkë financimi, planifikohen të realizohen nga:

- Grantet e donatorëve të ndara për projekte të ndryshme,
- participimet e qytetarëve dhe bashkëfinancimi për projekte të ndryshme.

Shkalla mesatare e mbledhjes së të hyrave vetanake gjatë vitit 2015, planifikohet të rritet për 14.36% në krahasuar me vitin 2014.

Për periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet rritja e të hyrave duke u bazuar në këta faktor:

- (i) ekzistimi i borxheve të bartura,
- (ii) implementimi i instrumenteve ligjore për zbatim,
- (iii) mbledhja e qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale nga ndërmarrjet ose personat fizik ,
- (iv) të hyrat e tatimit në pronë dhe
- (v) taksat – ngarkesat tjera.

Për të bërë planifikimin dhe shpërndarjen e drejtë për shpenzimet publike me Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2015-2017, në mënyrë të saktë egëzistojnë vështirësi, nga se mungojnë tregues të saktë zhvillimor.

Në drejtim të shpërndarjes dhe planifikimit të drejtë të parasë publike, është duke u përdor në nivel të Kosovës, formula me të cilën janë paraparë indikatorët –kriteret për shpërndarjen e granteve.

Për shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia e komunës,
- sipërfaqja e komunës,
- komunat e minoritetave,
- popullsia e minoritetave në komunë dhe
- shuma fiksë për komuna.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për Arsim në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- numri i shkollave në komunë,
- numri i nxënësve në shkolla fillore,
- numri i nxënësve në shkolla të mesme,
- numri i nxënësve shumicë si dhe
- numri i nxënësve pakicë.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për Shëndetësi në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia në komunë dhe
- numri mesatar i kontrolleve për kokë banori.

Në bazë të kriterieve të përmendura me parë është planifikuar dhe konstatuar që ndarja e granteve do të bëhet në mënyrë të drejtë dhe do ti përbush të gjitha nevojat fiskale për tri sektorët në nivel komunal.

**VI. Parashikimi i të hyrave komunale;** Parashikimi i të hyrave paraqet, terë pakon e të hyrave publike të planifikuara për realizim si mundësi financuese për shpenzime komunale dhe atë për tri vitet e ardhshme. Bazë për planifikimin e të hyrave, ka shërbyer,( Qarkorja Buxhetore nr. 2015/1 – komunat) e lëshuar nga MF, ku janë paraqitur kufijtë e granteve të aprovuara nga Komisioni i granteve dhe atë të ndarë si Granti i Përgjithshëm, Granti për Arsim dhe Granti për Shëndetësi; si dhe parashikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas fushave kryesore të hyrave duke u bazuar në politikat e të hyrave të komunës si dhe të aprovuara me rregulllore. Ky seksion përfshin tabelën e cila prezanton planifikimin e të hyrave të komunës nga të gjitha burimet, në bazë të fushave kryesore të hyrave për tri vitet e ardhshme.

Tabela  
nr.3

Përvitimi	2015 Plani	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi
<b>TË HYRAT VETANAKE</b>	<b>1,200,874</b>	<b>1,312,774</b>	<b>1,375,274</b>
Tatimi në pronë	250,000	300,000	303,000
Taksat komunale	565,574	605,400	659,000
Licencat dhe lejet	108,000	120,000	150,000
Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	90,000	98,000	90,000
Taksat e pajisjeve motorike	90,000	98,000	115,000
Lejet për ndërtesa	140,000	150,000	150,000
Taksat tjera komunale	97,574	99,400	114,000
<b>Ngarkesat komunale</b>	<b>155,000</b>	<b>157,374</b>	<b>165,274</b>
Ngarkesat regulatore	30,000	34,000	35,274
Të hyrat nga qiraja	20,000	24,000	23,000
Bashkë-pagesat për arsim	57,000	48,374	52,000
Bashkë-pagesat për shëndetësi	48,000	51,000	55,000
Ngarkesat tjera komunale			
<b>Të hyrat tjera</b>	<b>130,000</b>	<b>135,000</b>	<b>130,000</b>
<b>Shitja e aseteve</b>	<b>80,000</b>	<b>90,000</b>	<b>90,000</b>
<b>Grantet dhe donacionet</b>	<b>60,300</b>	<b>65,000</b>	<b>68,000</b>
Vendore			
Të huaja	60,300	65,000	68,000

## VII. Vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore

Planifikimi i të dalave – shpenzimeve publike për vitet 2015-2017, do të bëhet sipas Metodës së Buxhetimi Programor. Metoda e Buxhetimit programor, kërkon që shpenzimet të planifikohen për nga funksioni në programe, nën-programe të përcaktuara me Statutin e Komunës, por të bazuara në projekte, ndërsa për kah funksioni shpenzimet do të planifikohen në pesë kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, në pajtim me rregullat financiare për shpenzimet (SIMFK) të nxjerra nga Departamenti i Thesarit pranë MEF-it, dhe si vijon:

- paga dhe mëditje,
- mallra dhe shërbime,
- shpenzime të shërbimeve komunale,
- subvencione-transfere dhe
- shpenzime kapitale.

**Tabelat e kërkesave Fillestare për programe dhe kategori ekonomike të shpenzimeve**

**Viti 2015.**

Programet:	Paga-Med.	M-shërbime	Sherb.kom.	Subvencione	Shp. Kapitale	Gjithsej:
<b>Aministrata</b>	245,645	100,000	48,100	5,357	76,568	<b>475,670</b>
<b>Gjeod.- Kad.</b>	81,046	10,510	360		20,000	<b>111,916</b>
<b>Buxh.- Fin.</b>	90,671	15,000	360			<b>106,031</b>
<b>Bujq.-Zhvi.</b>	65,880	15,500	480	200,000		<b>277,880</b>
<b>Arsimi</b>	6,691,448	559,900	8,600	80,000	835,000	<b>8,252,348</b>
<b>Shëndetësia</b>	1,541,932	300,202	69,190	87,000	1,345,00	<b>3,343,324</b>
<b>Pl. Urban</b>	72,818	10,000	360		5,230,000	<b>5,313,178</b>
<b>Kultur-rini</b>	94,298	41,120	360	103,000	100,000	<b>338,778</b>
<b>Sherb. Publ.</b>	151,006	112,977	4,000	15,000	210,000	<b>492,983</b>
<b>Inspektioni</b>	71,445	40,200	360			<b>112,005</b>
<b>Z.Kryetarit</b>	116,015	38,202	1,500	30,000		<b>185,717</b>
<b>Z.Kuvendit</b>	108,920	17,520	360	5,000		<b>131,800</b>
<b>Z.Kumunitete</b>	8,500	3,000	360	4,000		<b>15,860</b>
<b>Gjithsej:</b>	<b>9,339,624</b>	<b>1,260,131</b>	<b>211,790</b>	<b>529,357</b>	<b>7,816,568</b>	<b>19,157,490</b>

Viti 2016.

<b>Programet:</b>	<b>Paga-Med.</b>	<b>M-shërbime</b>	<b>Sherb.kom.</b>	<b>Subvencione</b>	<b>Shp. Kapitale</b>	<b>Gjithsej:</b>
<b>Aministrata</b>	245,645	100,000	43,100	5,760	53,000	<b>448,602</b>
<b>Gjeod.- Kad.</b>	81,046	10,000	360		15,000	<b>106,506</b>
<b>Buxh.- Fin.</b>	90,671	16,000	360			<b>110,657</b>
<b>Bujq.-Zhvi.</b>	65,880	11,000	480	220,000		<b>297,360</b>
<b>Arsimi</b>	6,691,448	570,250	89,000	80,000	925,000	<b>8,355,698</b>
<b>Shëndetësia</b>	1,541,932	320,000	71,000	87,000	470,000	<b>2,489,932</b>
<b>Pl. Urban</b>	72,818	11,000	360		4,010,809	<b>4097,092</b>
<b>Kultur-rini</b>	94,298	41,120	360	150,000	150,000	<b>388,778</b>
<b>Sherb. Publ.</b>	156,976	120,527	7,000	17,000	242,000	<b>540,503</b>
<b>Inspektioni</b>	74,767	41,000	360		20,000	<b>136,127</b>
<b>Z.Kryetarit</b>	116,015	40,740	1,800	30,000		<b>188,555</b>
<b>Z.Kuvendit</b>	108,920	17,520	360	5,000		<b>131,800</b>
<b>Z.Kumunitete</b>	8,900	4,000	360	5,000		<b>18,260</b>
<b>Gjithsej:</b>	<b>9,355,344</b>	<b>1,303,257</b>	<b>211,900</b>	<b>552,760</b>	<b>5,886,609</b>	<b>17,309,870</b>

Viti 2017.

<b>Programet:</b>	<b>Paga-Med.</b>	<b>M-shërbime</b>	<b>Sherb.kom.</b>	<b>Subvencione</b>	<b>Shp. Kapitale</b>	<b>Gjithsej:</b>
<b>Aministrata</b>	246,142	100,000	43,100	6,710	49,300	<b>445,525</b>
<b>Gjeod.- Kad.</b>	81,046	10,000	360		5,000	<b>96,406</b>
<b>Buxh.- Fin.</b>	98,068	16,000	360			<b>114,428</b>
<b>Bujq.-Zhvi.</b>	65,880	11,000	480	250,000	935,000	<b>327,360</b>
<b>Arsimi</b>	6,691,448	590,170	92,100	80,000	200,000	<b>8,388,718</b>
<b>Shëndetësia</b>	1541,932	340,000	72,000	87,000	2,650,000	<b>2,240,932</b>
<b>Pl. Urban</b>	77,100	12,000	360		150,000	<b>2,739,460</b>
<b>Kultur-rini</b>	94,298	41,120	360	103,000	223,000	<b>388,778</b>
<b>Sherb. Publ.</b>	161,260	123,432	4,000	20,000		<b>531,692</b>
<b>Inspeкциони</b>	78,556	41,000	360			<b>119,916</b>
<b>Z.Kryetarit</b>	116,015	40,740	1,800	30,000		<b>188,555</b>
<b>Z.Kuvendit</b>	108,920	17,520	360	5,000		<b>131,800</b>
<b>Z.Kumunitete</b>	9,300	5,000	360	6,000		<b>20,660</b>
<b>Gjithsej:</b>	<b>9,369,965</b>	<b>1,347,982</b>	<b>216,000</b>	<b>587,710</b>	<b>4,212,300</b>	<b>15,733,957</b>

Katër kategoritë e para të shpenzimeve njihen si shpenzime operative të cilat me Qarkoren Buxhetore të MEF-it janë të limituara, për dallim nga kategoria e pestë e cila s'do të këtë kufizime. Maksimumi i rritjes së lejueshme të shpenzimeve operative do të jetë i kufizuar dhe i përcaktuar me Qarkoren e dytë Buxhetore të MEF-it e cila pritet të shpërndahet nga mesi i korrikut.

Numri i financuar i të punësuarve me Buxhetin Komunal 2015 është i lejueshëm në 1312punëtorë. Shpenzimet operative edhe gjatë viteve në vijim do të kontrollohen në mënyrë rigorozë dhe çdo here

të shkohet në zvogëlimin e tyre në atë mënyrë që shpenzimet për investime kapitale të jen nga viti në vit në rritje.

Si tani ashtu edhe në të ardhmen do ti kushtohet kujdes Implementimit më efektiv të shpenzimeve kapitale publike dhe shfrytëzimi i iniciativave të llojit të partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat dhe ky do të jetë synim kryesor për vitet në vijim.

Ndarja sektoriale e shpenzimeve në vitin 2015 planifikohet ne:

- Sektorin e përgjithshëm,
- Sektori i arsimit dhe
- Sektori i shëndetësisë dhe i mirëqenës sociale.

Në Strategjinë Fiskale 2015-2017 të t' gjitha Sektoret Komunale shifet së kemi një rritje të granteve, në krahasim me vitin 2014 e kjo rritje mund të shifet edhe të tabela e të hyrave për komunën tonë. Kjo rritje e granteve dhe të hyrave komunale është pozitive si për programet buxhetore ashtu edhe për subjekët tjerë- individ qe do të fitojnë subvencione e sidomos në bujqësi. Komuna do të ofronë politika të drejta financiare me prioritet të arsyeshme që është përfitimet e qytetarëve të Komunës së Drenasit.

## VIII. Strategjia zhvillimore për sektorët komunal

Komuna ka të përgatitur dhe të aprovuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe në te është cekur vizioni për të ardhmen; “ Komuna e Drenasit do të këtë infrastrukturë të përmirësuar fizike dhe mjedis të mbrojtur natyror, ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve, bujqësi intensive, rritje të punësimit, ngritisje të nivelit të arsimit dhe të edukimit sipas nevojave të tregut, shërbime cilësore publike, shëndetësore dhe administratë efikase”

Komuna në tri vitet e ardhshme do të këtë edhe këto objektiva për realizim dhe njëherit do të financoi tërësisht apo pjesërisht si vijojnë:

- a. shtimi i efikasitetit në punë që ndikon në zhvillimin ekonomik
  - i. përmirësimi i i kushteve për shërbime publike,
  - ii. përmirësimi i efikasitetit në shpenzimet e parave publike,
  - iii. shfrytëzimi maksimal i burimeve të mundshme,
  - iv. kryerja e punëve me kohë dhe në mënyrë të duhur.
- b. rritja e shpejtë e të ardhurave
  - i. shkalla më e lartë e arkëtimit të tarifave dhe ngarkesave
  - ii. insistimi në zgjerimin e fushave kryesore për të hyrat,
  - iii. ngarkesa të reduktuara me tarifa të zgjeruara,
- c. të sigurohet disiplina financiare
  - i. pajtueshmëri me politiken financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet ,
  - ii. ekzistanca e kontrolleve interne,

vi vendosja e forumit ekonomik.

#### **IX. Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:**

- a. Përgatitja e planit të punës 2015-2017
- b. Zbatimi i planit zhvillimor komunal dhe urban (2009-2020),
- c. Përgatitja e planit urbanistik,
- d. Përgatitja e kornizës afatmesme të shpenzimeve 2015-2017
- e. Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të dhënave dhe përdorimi,
- f. Shqyrtimi i përgjegjësive dhe obligimeve komunale,
- g. Kujdesi ndaj palës (menaxhimi i mirë i zyrës pritëse),
- h. Zbatimi më përpikëri i ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve në fuqi,
- i. Vendosja e pajisjeve për tërë stafin- Interneti,
- j. Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve.

Për faktin së Komuna e Drenasit, hynë në radhën e komunave më të pa zhvilluara, kërkohet një financim shtesë ose nga Qeveria e Kosovës ose nga donatorët e jashtëm në at mënyrë që sa do pak të përmisohet infrastruktura në nivel komunal. Kur thuhet përmisimi i infrastrukturës merret parasysh edhe dëmi i cili ka ndodhur gjatë luftës dhe duhet rindërtuar.

Komuna jonë tani përballet me një zhvillim më të shpejtë ekonomik e sidomos në Sektorin Privat të cilin sektor duhet ti sigurohen kushte të mirëfillta dhe të bazuara në ligje dhe mos të jen të rrezikuara investimet e këtij sektori.

Komuna me organet- administratën duhet mbështetur në forma të ndryshme e sidomos duhet mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme që do të ndikoi në zhvillimin ekonomik të komunës dhe në zvogëlimin e papunësisë. Në zvogëlimin e pa punësisë në komunën tonë do të ndikoi edhe investimi i punëtorëve tanë cilët janë të punësuar në diasporë. Paratë e dërguara nga diaspora janë një prej burimeve kryesore të hyrave për një numër të madh të familjeve, edhe pse ka një rënje nga e kaluara. Paratë e dërguara nga diaspora kanë ndikuar shumë në rindërtimin e shtëpive të banimit ekonomive familjare, gjë e cila mund të shihet ku do në teritorin e komunës.

Me krijimin e kushteve më të favorshme dhe përkrahjen teknike që do ta japi zyra për këshilla për biznes, punëtorët e diasporës do të interesohen më tepër për investime në Drenas.

Në bazë të regjistrimit i popullsisë dhe indikatorve tjera planifikohet që komuna jonë në vitin 2015 do të këtë rreth 61.000 banorë. Në bazë të disa vlerësimeve supozohet së në një familje mesatarisht

jetojnë prej: 5 deri në 9 anëtarë. Sa i për ketë të hyrave familjare mesatare në komunë nuk egëzistonë shënimet e sakta por edhe këtu vlerësohet së mesatarja e të hyrave vjetore përfamilje është 2.800 €.

Sektori finansiar, e veçmës sistemi bankar si komponent më e rëndësishme e tij pas lufte sidomos në tri vitet e fundit vazhdoi të tregon trend pozitiv të rritjes. Bankat komerciale kanë hapur përfaqësitet e tyre në Drenas, dhe tanë transaksionet financiare bëhen kryesisht përmes sistemit bankar që është një lehtësim si për sektorin privat ashtu edhe për individët. Bankat komerciale, kanë treguar një gatishmëri të madhe përfshirë dhënjen e kredisë, por dihet se kushtet e kredisë janë të pa favorshme përfshirë zhvillimin e biznesit dhe është vërejtur dukuria tjetër jo pozitive se shfrytëzimi i kredisë nga sektori privat bëhet kryesisht në degën ekonomike të tregtisë e jo në drejtim të ndërmarrjeve prodhuese.

Ne kemi nevojë përfshirë vendosur një sistem të fuqishëm të menaxhimit të informatave pasi që informatat janë vitale përmarrjen e vendimeve. Instalimi i pajisjeve moderne teknologjike, pastaj trajnimi i punëtorëve si dhe përpunimi i të dhënave në baza të rregullta janë aktivitetet kyçe të cilat kërkojnë vëmendje urgjente edhe në ketë periudhë.

## X. Planifikimi I Buxhetimit Programor I Bazuar në Performancë

## ZYRA E KRYETARIT

### Deklarata e misionit:

#### Zyra e Kryetarit

Deklarata e misionit: Bënë mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit finansiar të komunës, kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson komunën, në pajtim me Kryesuesin e Kuvendit konvokon mbledhjet e Kuvendit të komunës, nënshkruan të gjitha aktet e aprovuara nga Kuvendi Komunal, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të komunës, bënë propozime për qështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të komunës. Kjo zyre ka gjithsej 11 punëtorë.

### Zëvendës - kryetari

Deklarata e misionit: Bënë koordinimin e punëve me Komitetet e fshatrave dhe bashkësive, është mbikqyrës për marëdhënjet me publikun, koordinimi me mediat elektronike dhe të shkruara, zëvendësimi i kryetarit në rast të mungesës së tij.

### Njësia e Auditimit të Brendshëm

Deklarata e misionit: Planifikon, udhëheqë dhe mirëmban të gjitha kontrolllet e brendshme financiare në nivel komunal, kontrollon të gjitha deklaratat financiare, raportet financiare, dhe të gjitha shkresat financiare të Komunës, zhvillon auditime rrëth përdorimit të fondeve publike, raporton me shkrim për auditimet e kryera para Komitetit të Auditimit të Brendshëm, ofrimi i këshillave, sygjerimeve dhe rekondimeve përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të kontrollit të brendshëm, merr pjesë aktive gjatë kryerjes së auditimeve të jashtme të cilat kryhen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm apo ndonjë kompani e kontraktuar, mbanë rrjetin me homologët e tjera nëpër komuna dhe ministri, kontrollon rrjedhën e parasë së gatshme në mënyrë permanente etj.

### Zyra për informim.

Deklarata e misionit: bënë monitorimin e mediave dhe organizimin e tyre për shtyp, mbanë kontakt permanent me mediat e shkruara dhe elektronike, redaktimi i faqes zyrtare të internetit, arkivimi i materialeve të publikuara, publikimi periodik i raporteve dhe projekteve, botimi i ndonjë reviste komunale etj.

### Udhëheqësi i përsonelit.

Deklarata e misionit: Udhëheqë me stafin e Administratës së komunës. Harton Planin e rekrutimit dhe zhvillon rekrutomet. Harton Planin e trajnimit në bazë të nevojave për trajnim të ofruara nga menaxherët e programeve. Kujdeset për avancimin e vazhdueshëm professional të të gjith të punësuarve në administratën komunale.

### Zyra për integrime europiane.

Siguron që detyrat dhe përgjegjësitë e komunave nga PVPE- të të implementohen me kohëKoordinon aktivitetet me Kryetarin dhe Drejtoret që të implementohen obligimet nga ato PVPE. Bashërendon veprimtaritë me të gjithë zyrtarët komunal . Pregaditë Planet e veprimit për implementimin e PVPE-së. Raporton te Kryetari dhe MPL në lidhje me vepromet e ndërmarrura për implementimin e PVPE.

**Avokati komunal.**

Përfaqëson komunën në të gjitha rastet dhe kontestet gjyqësore. Mbronë interesat e komunës në rastet e hapura gjyqësore. Pregaditë dokumentacionin e nevojshëm për mbrojtjen e interesave të komunës dhe merr pjesë në seancat gjyqësore.

**Deklarata e Vizionit:**

Deklarata e Vizionit: Avancimi dhe perfekcionimi i menaxhimit në pajtim me të gjitha normat ligjore. Arritura e pajtueshmërisë së plotë me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon komuna. Shfrytëzimi i mjeteve buxhetore me një nikoqirillak dhe duke u bazuar në parimin vlera për paratë. Avancimi i vazhdueshëm profesional i të gjitha burimeve humane.

**Deklarata e Qëllimit:**

Deklarata e Qëllimit: Ngritura e zhvillimit ekonomik. Ngritura e nivelit të mirëqenjes sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim. Ofrimi sa më i mirë i të gjitha shërbimeve për qytetarët e komunës. Shëndrrimi i administratës në një administratë moderne, sa më funksionale dhe të rregullt. Shfrytëzimi sa më racional dhe ekonomik i të gjitha burimeve njerëzore, financiare dhe materiale që ka komuna në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Kategoritë buxhetore	2015	2016	2017
1. Paga dhe mëditje	116.015.50	116.015.50	116.015.50
2. Mallra dhe shërbime	38.202.00	40.740.00	40.740.00
3. Shërbimet Komunale	1.500.00	1.800.00	1.800.00
4. Transfere dhe subvencione	30.000.00	30.000.00	30.000.00
5. Kapitale			
<b>TOTALI:</b>	<b>185.717.50</b>	<b>188.555.50</b>	<b>188.555.50</b>

**Numri i të punësuarve :**

Performanca; Lëndve:	Nr.	2015	2016	2017
Kuntitativ:				
Konvokimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me Kryesuesin	12	12	12	
Pjesmarria në mbledhjet e Komitetit për politikë e financa dhe të gjitha komiteteve tjera	100	100	100	
Përfaqësimi i komunës brenda dhe jashtë vendit				
Organizimi i mbledhjeve me publikun dhe përfaqësuesit e komuniteteve	15	15	15	
Kryerja e auditimeve të rregullta	8	8	8	
Raportimet para Komitetit të Auditimit	6	6	6	
Raportimet para Njësisë Qendrore Harmonizuese	4	4	4	
Bashkëpunimi me Auditorët e jashtëm në kryerjen e Auditimit të rregullt vjetor	1	1	1	
Monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike	365	365	365	
Redaktimi i faqes zyrtare të informimit të komunës	200	200	200	
	5	5	5	

Rekrutimet e punonjësve të rinjë	70	70	70
Trajnimi i punonjësve	70	70	70
Avancimi i punonjësve			
Raportimi për rrjedhën e detyrave në lidhje me PVPE	10 50	10 50	10 50
Bashkëpunimi dhe mbikqyrja në realizimin e detyrave që dalin nga PVPE	30	30	30
Përfqësimi i komunës në kontestet gjyqësore	946	946	946
Gjithsej kuantitative:			
Kualitativ:			
Mbikqyrja e përgjithshme administrative			
Ekzekutimi i vendimeve që dalin nga Legjislativi			
Përkuqdesi i vazhdueshëm për zbatimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore			
Mbajtja e mbledhjeve me publikun dhe komunitetet			
Koordinimi i punëve me komunitetet e fshtatrave dhe vendbanimeve			
Kryerja e aktiviteteve audituese të ligjshmërisë dhe regullsisë			
Dhënja e rekomandimeve për përmirësim dhe përcjellja e implementimit të tyre.			
Planifikimi vjetor dhe strategjik i auditimeve			
Monitorimi i mediave			
Publikimi i të dhënave dhe raporteve në ueb faqen zyrtare të komunës			
Kryerja e rekrutimeve dhe plotësimi i nevojave për staf			
Planifikimi i stafit dhe trajnimi dhe avancimi i tij			
Mbikqyrja e vazhdueshme në lidhje me përbushjen e obligimeve që dalin për integrime europiane			
Përgaditja e dokumenteve të nevojshme për seancat e mundshme gjyqësore			
Përfaqësimi dhe mbrojtja e komunës në kontestet me palët e treta.			

Të gjitha punët e planifikuar sipas viteve 2015-2017 do të kryhen me kualitet nëse lejohet buxheti i kërkuar me lartë, në të kundërtën do të mungoj si kualiteti ashtu edhe kuantiteti.

## ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

**Deklarata e misionit:** Raporton rregullisht Kryetarin e Komunës për punën e zyrës,i dorëzon Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal raport vjetor,paraqet raport në çdo takim të Komitetit për Komunitete,informon dhe raporton tek institucionet e Qeverisë Qendrore lidhur me aktivitetet e zyrës,i propozon Kryetarit të Komunës një buxhet vjetor për të siguruuar një funksionim të duhur të zyrës dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në bazë të kompetencave të veta,merr pjesë në mbledhjet e Drejtoreve të Komunës,bashkëpunon ngushtë me institucionet e Qeverisë Qendrore dhe me organizata të tjera vendore e Ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të Komuniteteve,Kthimit dhe Riintegrimit.

**Deklarata e Vizionit:** Të kontribuon drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etiike,prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta.

**Deklarata e Qëllimit:** Të këshilloj autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre,qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve.

Performansën:

Kategoritë buxhetore	2015	2016	2017
1. Paga dhe mëditje	8,500	8,900	9,300
2. Mallra dhe shërbime	3,000	4,000	5,000
3. Shërbimet Komunale	360	360	360
4. Transfere dhe subvencione	4,000	5,000	6,000
5. Kapitale			
<b>TOTALI:</b>	<b>15,860</b>	<b>18,260</b>	<b>20,660</b>

Numri i të punësuarve :	1	1	1
-------------------------	---	---	---

	2015	2016	2017
Gjithsej, kuantitative :			
- Vizita tek personat e riatdhesuar	280	330	340
- Vizita tek komunitetet pakicë	50	80	85
- Shqyrtimi i kërkesave të tyre	80	90	80
- Mbledhjet me Komitetin për Komunitete	10	11	10
-Mbledhjet me Komisionin Komunal për Riintegrin	8	10	8
-Takime me Institucionet e Qeverisë së Kosovës	34	30	36
- Takime me organizata lokale dhe nderkombëtare	18	20	16
- Trajnimet dhe Seminare			

Të gjitha punët e planifikuar sipas viteve 2014-2016 do të kryhen me kualitet nëse lejohet buxheti  
i kërkuar me lartë, në të kundërtën do të mungoj si kualiteti ashtu edhe kuantiteti.

### ZYRA E KUVENDIT

Deklarata e misionit: zbatushmeria e Ligjeve në fuqi ,pergaditja e akteve normative në përputhshmëri me Ligjin si dhe arhivimin e të gjithave këtyre akteve
Deklarata e Vizionit: planifikimi i punëve sipas ligjit për vëtëqeverisje lokale dhe akteve tjera ligjore në fuqi si dhe realizimin e këtyre punëve sipas planifikimit
Deklarata e Qëllimit: Përgaditja e materjalit për Kuvend , mbajtja e proces verbaleve dhe nxjerrja e Vendimeve të aprovuara nga Kuvendi si dhe dergimi I këtyre akteve pwr MAPL- al

Kategoritë buxhetore	2015	2016	2017
1. Paga dhe mëditje	108,920	108,920	108,920
2. Mallra dhe shërbime	17,520	17,520	17,520
3. Shërbimet Komunale	360	360	360
4. Transfere dhe subvencione	5,000	5,000	5,000
5. Kapitale			
<b>TOTALI:</b>	<b>131,800</b>	<b>131,800</b>	<b>131,800</b>

Numri i të punësuarve :	2015	2016	2017
Performanca;	Nr.		
Lëndve:			
1. Kuntitativ:			
- Planifikimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvëndit Komunal dhe mbledhjeve të K.P.F gjithsej janë (12) mbledhje në vit.	12	12	12
- Pranimi i propozim vendimeve nga ekzekutivi gjegjësisht Kryetari i Komunës dhe dergimi i këtyre propozim vendimeve këshilltarve të Kuvëndit 7 ditë para mbledhjes	60	60	60
- Mbajtja e procer verbalit të mbledhjeve të K.P.F dhe të Kuvëndit të Komunës.	24	24	24
- Përgaditja e vendimeve të aprovuara nga Kuvëndi Komunal i Drenasit si dhe dërgimi i këtyre akteve Kryetarit të Komunës e më pas Ministrit së APL..	48	48	48
- Takimet e komitetit për Komunitete dhe takimet e Komiteteve konsultative si komisioneve te formuara			

nga Kuvendi			
Gjithsej, kuantitative :	144	144	144

